

AKT - THEMELIMI

ISHOQERISE TREGTARE PRIVATE TREGTARE "VELLEZERIT LLUPO" sh p k

Sot, në datën 20.10.1999, në Berat, ne ortaket themeluese: 1) Frederik Llupo, i biri i Vangjelit, i dt. 1966, banues ne Berat lagjja "30 Vjetori, me pasaporten nr. 0255488 2) Aleks Llupo, i biri i Vangjelit, i dt. 1969, banues ne Berat, lagjja "30 Vjetori" me pasaporten nr. 0255475 3) Nikolla Llupo, i biri i Vangjelit, i dt. 1975, banues ne Berat lagjja "30 Vjetori" me pasaporten nr. 0962848 4) Vangjel LLupo, i biri i Thimiut, i dt. 1938, banues ne Berat, lagjja "30 Vjetori", me pasaporten nr. 0873798 themelojne shoqerine tregtare private "Vellezerit LLupo" sh p k.

Veprimtarinë kjo shoqëri do ta ushtroje në gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Selia e saj ndodhet në qytetin e Ures Vajguore.

Objekti i veprimtarisë së kësaj SH. P. K. është:

- Prodhimi i te gjitha llojeve te inerteve dhe materialeve te ndertimit.
- Tregtimi me shumice dhe pakice i te gjitha llojeve te inerteve , materialeve te ndertimit import - eksport.

- Tregtimi me shumice dhe me pakice import - eksport i pajisjeve elektro-shtepiake, i pjeseve te nderrimit per makina, artikuj ushqimore, industriale, bujqesore, blegtorale etj.

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë e vazhdueshme, me afat kohor mbi 10 vjet dhe do të fillojë mbas regjistrimit në Gjykatën e rrethit Tiranë.

Kapitali themeltar fillestar i kësaj shoqërie përbëhet nga shuma 100 000 lekë të depozituara në Degën e Bankës Kursimeve Berat, e cila është pronë e ortakëve themeluese kontribut e secilit ne pjese te barabarta.

Te ardhurat ne shoqeri do te ndahen ne pjese te barabarta ne perputhje me pjesen e kontributit te secilit ortak ne kapitalin e themelimit pasi jane zbritur te gjitha shpenzimet e tjera dhe detyrimet fiskale naj shtetit.

Administator i shoqerise eshte emeruar z. Frederik Llupo.

E gjithë veprimtaria e kesaj shoqerie do te zhvillohet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, me Kodin Tregetar dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore qe rregullojne keto marredhenie.

Ortakët themeluese i kesaj shoqerie kane te drejte ne çdo kohe te shtoje kapitalin e tij te themelimit, te pranoje ortake te tjera duke bashkuar kapitalin e tij me kapitalin e personave te tjere te trete.

Kapitali i themelimit te kesaj shoqerie eshte i transferueshem dhe kalimi tij behet dhe ne ruge trashegimore.

Ortakët themeluese te shoqerise mund te bejne mbylljen e veprimtarise se shoqerise ne çdo kohe dhe per çdo shkak duke kryer me pare te gjitha veprimet e likuidimit sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Marredheniet e kesaj shoqerie me persona te tjere te trete do te behen nenpermjet kontratave, marreveshjeve ligjore.


THEMELUESIT E SH P K "VELLEZERIT LLUPO"

Frederik Llupo

Aleks Llupo

Nikolla Llupo

Vangjel Llupo



STATUT
I
SHOQERISE PRIVATE "VELLEZERIT LLUPO" SH. P. K
FORMIMI

Neni 1

Në bazë të aktit themelues në datë 21.10.1999 është krijuar SH. P. K. "Vëllezrit Llupo" me ortakë themeluese z. 1) Frederik Llupo, i biri i Vangjelit, i dt. 1966, banues ne Berat, 2) Aleks Llupo, i biri i Vangjelit, i dt. 1969, banues ne berat dhe 3) Nikolla Llupo, i biri i Vangjelit, i dt. 1975, banues ne Berat 4) Vangjel LLupo, i biri i Thimiut, i dt. 1938, banues ne Berat

EMRI, QENDRA, TERITORI

Neni 2

Emri i shoqërisë do të jetë "VELLEZERIT LUPO" SH. P. K.

Neni 3

Qendra, selia e shoqërisë do të jetë në qytetin e Ures Vajgurore, lagjja "4 Shtatori".
Veprimtarinë e saj, kjo shoqëri e zhvillon në gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashte saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie do te jete:

- Prodhimi i te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, inerteve.
- Tregtimi me shumice dhe me pakice i te gjitha llojeve te inerteve dhe materialeve te ndertimit import - eksport.
- Tregtimi me shumice dhe pakice import - eksport te pajisjeve elektroshtepiake, pjeseve te nderrimit per makina, artikuj ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale.

Neni 5

SH. P. K. "Vellezerit Llupo" do të ushtrojë një veprimtari me afat kohor të pacaktuar mbi 10 vjet.



KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali i SH. P. K. "Vellezerit Llupo" përbëhet nga kapitali në të holla prej 100 000 leke i depozituar në Degën e Bankes se Kursimeve Berat.

Ky kapital është pronë ekskluzive e ortakeve themelues te saj kontribut i secilit prej ortakeve ne pjese te barabarta.

Me rritjen e veprimtarisë financiare të shoqërisë, kapitali mund të rritet me vendim të



ortakeve të saj themeluese.

Neni 7

Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë kapitalet mund të depozitohen dhe në Bankat e tjera shtetërore ose private.

Neni 8

Transferimet e kapitalit themeltar e të depozituar bëhen vetëm me akt noterial. Shoqëria apo të tretët detyrohen të respektojnë këto transferime sapo të bëhen të ditura ato.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme edhe në rrugë trashëgimnie.

Neni 9

Pjesë të kapitalit themeltar mund t'u transferohen edhe personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, por vetëm me vendim të themelueseve të shoqërisë dhe, në rast të shtimit të numrit të ortakëve, me miratimin e shumicës së ortakëve, që përfaqësojnë 3/4 e pjesëve të kapitalit.



ORGANIZIMI E DREJTIMI

Neni 10

Shoqëria tregtare private "Vellezerit Llupo" do të drejtohet prej organit drejtues te saj qe eshte asambleja e shoqerise.

Administrator i saj do te jete z. Frederik Llupo.

Neni 11

Administratori ka për detyrë organizimin e drejtimin e shoqërisë. Brenda fushës së veprimtarisë së saj ai ka këto kompetenca:

- Disponon firmën në Degën Bankare ku ka llogarinë si dhe zgjidh pranë këtij institucioni çdo problem financiar që mund të lindë.

- Të hyjë në marrëdhënie me shoqëri të tjera të vendit ose të huaja si dhe të japë e të marrë hua.

- Vendos për marrjen ose largimin nga puna të të punësuarve, nxjerrjen e tyre në asistencë si dhe mënyrën e shpërblimit të tyre.

- Mban regjistrin themeltar të punonjësve dhe merr ndaj tyre masa me karakter edukativ dhe administrativ.

- Cakton dhe jep lejet e zakonshme.

- Ndjek ritmikisht aktivitetin e shoqërisë si dhe cakton ekspert kontabël për kryerjen e llogarive të saj.

Neni 12

Ortakët themeluese mund të emërojnë një ose më shumë administratorë të tjerë, duke caktuar detyrat dhe pagat e tyre.

Ortakët themeluese mund të emërojnë punonjës dhe për kujdestari të veçantë. Ata mund të emërojnë një këshill administrativ, që do të ketë fuqi vendimore.

Neni 13

Administratori i emëruar humbet punën, detyrën e tij, në rastin e prishjes së shoqërisë ose kur shkarkohet nga ortakët themelues të shoqërisë. Kjo mund të kryhet me anë të një akti me shkrim.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 14

Shoqëria përfaqësohet nga administratori, e drejte kjo e dhene nga ortakët themeluese . Në raste të veçanta, mund të përfaqësohet nga nje person tjetër i autorizuar nga ortakët themeluese

Neni 15

Administratorët jo ortakë të emëruar kanë për detyrë të zbatojnë të gjitha urdhërat e vendimet e themelueseve të shoqërisë gjithmonë brenda kompetencave të caktuara për ta.

Neni 16

Ortakët themelues ose administratorët e emëruar prej tij, kanë te drejte te paraqesin kërkesa gjyqësore, të zgjedhin ose anullojnë avokatin për çështjet në gjykim.

ASAMBLEJA

Neni 17

Asamblea është organi drejtues i shoqërisë dhe organi më i lartë i saj. Ajo perbehet nga ortakët themeluese dhe nga persona të tjere të percaktuar me vendim të ortakëve themeluese por pa të drejtë vote.

Thirrja e asamblesë për mbledhje bëhet me njoftim nga ortakët themeluese 10 ditë para ditës saj. Në njoftim caktohet vendi i mbledhjes, data dhe ora si dhe emërtimet e materialeve që do të trajtohen.

Çdo ortak mund të përfaqësohet në asamble vet ose nga një ortak tjetër me akt përfaqësimi.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabarta me pjesët e kapitalit themeltar, që disponon në shoqëri.

Asamblea miraton ndryshimet ne statut me pjesemarrjen e mbi 3/4-tave te anetareve te saj.

Asambleja drejtohet nga ortaku më i vjetër ose nga personi i zgjedhur nga asambleja.

Shoqëria mban librin e vendimeve të Asamblesë. të shpenzimeve të të ardhurave, etj.

Vendimet ne Asamble merren me shumice absolute votash.

MBI KONTROLL - REVIZIONIN

Neni 18

Ortakët themeluesë mund të caktojë kontrollor (ekspert) për veprimtarinë ekonomike - financiare të shoqërisë. Pagat për të caktohen nga ortaku i vetem themeluese.

Ekspertët kontrollojnë gjithë veprimtarinë ekonomiko - financiare të shoqërisë për një

BILANCI E TE ARDHURAT

Neni 19

Veprimet e shoqërisë mund të mbylLEN më 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe, administratorët e emëruar, ortaket themelues ose ekspertët e caktuar prej tij, nxjerrin bilancin kontabël të shoqërisë ose rezultatin ekonomik me fitim ose humbje, sipas rregullave në fuqi.

Neni 20

Të ardhurat nga veprimtaria private e shoqërisë do të sigurohen sipas çmimeve, që i cakton vetë shoqëria. Çmimet e tarifat e shërbimit caktohen në bazë të kërkesë - ofertës.

Neni 21

Të ardhurat neto, pas zbritjes së gjithë detyrimeve ligjore e krijimit të fondeve të akumulimit, mbetet pasuri e ortakëve themeluesë të saj. Ato ndahen midis tyre ne perputhje me pjesen e kapitalit te themelimit te vene prej çdo ortaku.

MARRËDHËNIET E PUNES

Neni 22

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës ose marrëveshjes dy palëshe.

Për çështjet që nuk rregullohen me kontratë, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 23

Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit e të sigurimeve shoqërore për të punësuarit në të.

Të punësuarit detyrohen të respektojnë statutin e shoqërisë dhe kushtet e caktuara në kontratë.

Neni 24

Të punësuarit në shoqëri përgjigjen sipas ligjit të këtij statuti për zbatimin e detyrave dhe për dëmet e shkaktuara për kryerjen e detyrave të tyre. Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e shoqërisë edhe në rastin kur largohen prej saj.

SHPERBERJA

Neni 25

Shpërbërja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë e për çdo lloj shkak. Eshtë kompetencë ekskluzive e ortakeve themeluese të përcaktojë mënyrat e likuidimit të shoqërisë. Për këtë mund të caktojë një ose më shumë likuidatorë për të nxjerrë rezultatin dhe mbylljen aktivitetit të shoqërisë.

Shpërbërja e shoqërisë bëhet ne baze te ligjit "per shoqerite tregtare".



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 26

SH. P. K "Vellezerit Llupo" është person juridik i pavarur. Ajo ka të drejta e detyrime për të cilat përgjigjet brenda kufijve të përcaktuar në ligjin Nr. 7512 datë 10. 8. 1991.

Neni 27

Themeluesit e kësaj shoqërie ka derdhur kapitalin e tij me qëllim që të fitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themeltar.

Neni 28

Shoqëria "Vellezerit Llupo" SH. P. K. është person juridik dhe fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Neni 29

Themeluesit e shoqërisë, në rast të shtimit të numrit të ortakëve, kane të drejtë të bëjnë ndryshimet e nevojshme në statut dhe të hartojnë kontratat e përbashkëta me ortakë të tjerë. Ndryshimet pasqyrohen në regjistrimin pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 30

Mosmarrëveshjet e shoqërisë me të tretët, me persona juridikë vendas apo të huaj, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt, sipas dispozitave ligjore në fuqi të legjislacionit shqiptar.

Neni 31

Statuti u përpilua në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, për t'ua dhënë organeve kompetente.

U nënshkrua sot, në datë 21.10. 1999

Ortakët themeluesë

FREDERIK LLUPO

ALEKS LLUPO

NIKOLLA LLUPO

VANGJEL LLUPO

Republika e Shqipërisë
Notere Nikoleta Manka Berat
Nr. 2311 vep.
Nr. 645 kol.

VERTETIM

Sot me datën 21.10.1999, ne Berat, para meje noteres Nikoleta Manka u paraqit personalisht ortakët themelues të sh p k "Vellezerit Llupo" Berat, Frederik LLupo, Aleks LLupo, Nikolla LLupo dhe Vangjel Llupo për identitetin e të cilëve u njoha kundrejt leter njoftimeve personale perkatesisht o255488, 0255475, 0962848 dhe 0873798. Ata deklaruan para meje se statutin e mësipërm e kane hartuar me deshiren dhe vullnetin e tyre te lire duke e nenshkuar para meje dhe me noteria e vertetoi regullisht sipas ligjit.

